

URDHËR
Nr. 532, datë 6.11.2019

**PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONIT ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR PRIVAT, KOPSHTI “HAPAT E PARA”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 3 dhe 7, të nenit 42 dhe pikës 3, të nenit 70, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të udhëzimit nr. 15, datë 12.7.2013, “Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për licencë të institucioneve arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor parauniversitar privat, kopshti “Hapat e Para”, Tiranë, licencuar me licencë të QKL-së nr: LN-7482-02-2014.

2. Institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti “Hapat e Para”, Tiranë, ka këto detyrime:

a) të kthejë pagesat e kryera nga nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërbushur që mund të ketë ndaj nxënësit;

b) të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për transferimin e nxënësve, në zbatim të këtij urdhri, të mbulohen nga institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti “Hapat e Para”, Tiranë;

c) të dorëzojë në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar, Tiranë, të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë e kryer.

3. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë, të administrojë dokumentacionin e depozituar nga institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti “Hapat e Para”, Tiranë.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, sekretari i përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Derregullimit, Lejeve, Licencave dhe Monitorimit në MASR, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë dhe institucioni arsimor parauniversitar privat, kopshti “Hapat e Para”, Tiranë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË
Besa Shahini